



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 23 datë 22/12/2023

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2024”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-së nr. 625, datë 28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 6, datë 27.06.2023 “Mbi riorganizimin e strukturës organizative, klasifikimin nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2023”, si dhe VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Struktura aktuale do të pasqyrohet me ndryshimet përkatëse edhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Korçë, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 30.03.2020, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024 sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i pagave, i miratuar për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ERJON NEXHIPI

Konceptoi: R. Latollari
Konfirmoi: Gj. Kristo
Pranoi: Sek.K.Q.K.: B. Muço

